

REZYME MBI TEZËN E NIVELIT MASTER  
PROCESI I INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN, RASTI I TURQISË

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I ARTEVE NË INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË  
PUBLIKE

NGA  
ARDIAN AHMETI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
Integrime Evropiane dhe Administratë Publike  
PRISHTINË

SHKURT, 2022

## **Procesi i integritit në Bashkimin Evropian, rasti i Turqisë**

Mentorja : Prof. Ass. Dr. Jehona Lushaku

Turqia është i vetmi shtet që edhe pse e ka statusin formalisht të kandidatit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian negociatat për anëtarësim shpesh herë kanë filluar dhe janë ndërprerë rrjedhimisht e ardhmja e saj në BE nuk është e qartë.

Si qellim kryesor që unë dua ta shtjellojë është; *Pse Turqia s'arrinë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian?*, përkundër fakteve që Turqia edhe Bashkimi Evropian bashkëpunojnë në fushat të ndryshme, do të mundohem që të tregoj se Bashkimi Evropian ka arritur që ti ketë 27 anëtarë si pasojë e plotësimit të kriterëve si proces politikë apo teknik të anëtarësimit apo si pasojë e kërcënimeve të jashtëm siç ka qenë komunizmi në të kaluarën dhe nganjëherë me mos plotësimin e kushteve të anëtarësimit sidomos në fushën ekonomike, në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe nganjëherë si pasojë e anëtarësimit në pako.

Turqia shtrihet në dy kontinente të ndryshme, lidh Evropën me Azinë, shpesh herë është konsideruar si një shtet që e lidh Evropën me Azinë, në disa raste ka shërbyer si urë lidhëse në mes lindjes dhe perëndimit, pastaj pozita e saj gjeografike ia mundëson që të ketë një vend të rëndësishëm në politikën ndërkombëtare, në këtë kontekst do të mundohem që të tregojë, rrjedhën që çoi drejt krijimit të aleancës veri atlantike NATO-s, si përgjigje ndaj komunizmit dhe krijimin e Bashkimit Evropian si bashkëpunim në mes shteteve në fushën ekonomike, politike deri tek krijimi i një unioni që thirret me ruajtën e vlerave të përbashkëta por edhe bashkëpunimin doganor për liri të lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe të kapitalit.

Bashkimi Evropian më një popullatë rreth 500 milion banor është një gjigant ekonomik, së bashku me SHBA-të mbetet rol kyç në politikën botërore, shpesh herë Turqisë i'u është dhënë epiteti si një vend më rëndësi të veçantë në politikën botërore pasi që e lidh Evropën me Azinë.

Për të arritur në fund se : pse s'ka arritë të anëtarsohet Turqia në Bashkimin Evropian?, janë një mori arsye apo kushte që janë (politike, juridike, ekonomike dhe administrative) që duhet të plotësuar për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

#### METODOLOGJIA :

Për realizimin e këtij punimi do të mbështetem në metodat të cilat janë:

1. Kualitative( do të bazohem në burime primare dhe sekondare)
2. Krahasuese (do të bëjë krahasim pra duke krahasuar shtetin e Greqisë që është shtet anëtar i BE me shtetin e Turqisë).
3. Analitike ( do të fokusohem në analizën e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe e gjendjen faktike që gjendet Turqia)

Hulumtimi synon ti jap përgjigjie në pyetjen hulumtuese : Pse Turqia s'arrinë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian?

#### **Përmbledhje e Shkurtër e Kapitujve**

**Në kapitullin e parë** do të flas për shtjellimin e integrimit Evropian si koncept, pastaj për historinë e themelimit të BE-së, për traktatet dhe valët e zgjerimit të Bashkimit Evropian, rreth historisë së shtetit të Turqisë dhe do të analizohen raportet në mes BE-së dhe Turqisë në periudhën 1957-2000.

**Në kapitullin e dytë** do të flas për teorinë e integrimit Evropian dhe në cilën teori mbështet apo arsyetohet integrimi Turqisë në Bashkimin Evropian.

**Ndërsa në kapitullin e tretë** do të flas rreth kritereve, kërkesat apo kushtet që duhet plotësuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian, edhe gjendjen faktike të Turqisë në fushat e caktuara me theks të veçantë për ato kritere në të cilat kritikohet në vazhdimësi Turqia për mos përmbushje të kritereve.

**Në kapitullin e katërt** do të flas për anëtarësimin e Greqisë në BE, Mosmarrëveshjet e Greqisë dhe Turqisë lidhur me Qipron Jugore dhe Veriore dhe rolin e Greqisë për anëtarësimin e Turqisë në Bashkimin Evropian, si dhe argumentet pro dhe kundër anëtarësimit të Turqisë në Bashkimin Evropian.

**Në kapitullin e pestë** do të analizohen raportet e Turqisë dhe BE gjatë periudhës 2000-2020.